

Ftesë për pjesëmarrje në Hulumtimin lidhur me ndihmen juridike falas

A jeni student në Fakultetin juridik? A dëshironi që përmes hulumtimit dhe shkrimit të kontribuoni në përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe të fitoni aftësi të reja në aspektin e hulumtimit?

UNDP në bashkëpunim me **Institutin për Hulumtime dhe Studime Juridike / Fakulteti Juridik**, dhe **Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas** ju fton të merrni pjesë në Hulumtimin me temën:

“Cilat janë përparësitë dhe mangësitë e Ndhmes Juridike Falas në Kosovë dhe si mund të përmirësohen shërbimet e ndihmes juridike falas në Kosovë?”

Kriteret: Hulumtimi duhet të jetë jo më shumë se 2,000 (dy mijë) fjalë. Vetëm ato punime të cilat dorëzohen me numër valid të indeksit të Fakultetit Juridik do të pranohen. Në këtë garë mund të marrin pjesë studentë te nivelit BA dhe Master. Ndalohet çdo lloj plagjiature. Në rast të vërtetimit se egziston plagjiatura aplikuesi do të diskualifikohet pa të drejtë ankese.

Idetë inovative do të vlerësohen deri në 10 pikë shtesë.

Tre punimet më të mira do të shpërblehen me mirënjohje dhe me shumat prej EUR 400 (vendi i parë), EUR 300 (vendi i dytë) dhe EUR 200 (vendi i tretë).

Hulumtimet duhet të dorëzohen deri me 12 shtator përmes e-mail në: registry.ks@undp.org, me titull në e-mail: Hulumtimi për ndihmën juridike falas.

Hulumtimet të cilat hyjnë në rrethin e ngushtë do të vlerësohen nga një komision i pavarur në përbërje nga tre profesionistë të fushës nën mbikqyrje të UNDP.

Apliko dhe kontribo!

